



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:257962

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05379469

C.nr.3906/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Diora Bajrami, me zyrtaren ligjore A.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëseve Y.H. dhe M.M. nga Prizreni të cilat me autorizim i përfaqëson avokat V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën e përfaqëson V.I.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlerë e kontestit 652 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 27.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

- I.** APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëseve Y.H. dhe M.M. nga Prizreni.
- II.** DETYROHET e paditura, që paditësve, në emër të kompensimit të ushqimit në punë, tua paguaj:
 1. Paditëses Y.H. në emër të ushqimit në punë për 163 ditë pune (për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 326 euro (treqind e njëzetë e gjashtë), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 14.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
 2. Paditëses M.M. në emër të ushqimit në punë për 163 ditë pune (për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022) t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 326 euro (treqind e njëzetë e gjashtë), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 14.12.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III.** DETYROHET e paditura që paditësve t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 176.00 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) euro, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset Y.H. dhe M.M. nga Prizreni përmes të autorizuarit të tyre av. V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 14.11.2023, kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shujtave.

I autorizuari i paditësve në padi ka theksuar se paditëset janë në marrëdhënie pune në SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren dhe të njëjtave nuk iu janë paguar shujtat ditore, bazuar në nenin 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësve vullnetarisht, gjykatës i kanë propozuar gjykatës që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përfaqësueses ligjore të komunës, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, lidhur me kompensimin e shujtës ditore. Ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me numër 01B/488, të datës 21.11.2022, për shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësës është e pabazuar si dhe sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/23 i datës 05.10.2023, rastet e të punësuarve që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave që dalin nga kontrata e lartpërmendur, duhet trajtuar deri me datë 21.11.2023, kur kjo kontratë është shkëputur nga njëra prej palëve kontraktuese. Po ashtu sipas të autorizuarës së të paditurës përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Po ashtu ka theksuar se të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e saj. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht mësimdhënëse në SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër të referencës 234/2023, të datës 21.09.2023, të lëshuar nga drejtoresha e shkollës SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Y.H. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 163 ditë pune. Nga vërtetimi me numër të referencës 234/2023, të datës 21.09.2023, të lëshuar nga drejtoresha e shkollës SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësja M.M. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune-mësimdhënëse pranë kësaj shkolle dhe e njëjta për vitin 2022, dhe atë nga data 01.01.2022 e deri me datë 21.11.2022, ka punuar gjithsej 163 ditë pune.

Vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Andaj pasi vërtetimet janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, gjykata ua fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, me numër 01/B, numër të prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktua e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Nga gjendja faktike e vërtetuar rezultoi se e paditura ka detyrimin e pagesës në emër të ushqimit në punë, ngase përmes vërtetimit të prezencës në punë për paditëset është vërtetuar se paditësja Y.H. për vitin 2022 (periudhë 01.01.2022-21.11.2022) ka realizuar gjithsej 163 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 326 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 163 me numrin 2€ (163x2), po ashtu përmes vërtetimit të prezencës në punë është vërtetuar se paditësja M.M. për vitin 2022 (periudhë 01.01.2022-21.11.2022) ka realizuar gjithsej 163 ditë pune, e që në rastin konkret të njëjtës i takon shuma prej 326 euro e cila është llogaritur duke e shumëzuar numrin e ditëve të punës 163 me numrin 2€ (163x2),

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*,

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashkrimit të padisë në këtë gjykatë (14.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritore.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e

shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 156 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 176.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3906/2023, datë 27.02.2024

G j y q t a r e

Diora Bajrami

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.